



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA THEMELORE GJILAN

---

Numri i lëndës: 2018:071829

Datë: 29.03.2019

Numri i dokumentit: 00261345

P.nr.28/2019

**NË EMËR TË POPULLIT**

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin e vetëm gjykues Rilind Sermaxhaj, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Berna Maliqi, në çështjen penale kundër të pandehurit Q. L. nga Gjilani, për shkak të veprës penale sulmi nga neni 187 paragrafi 1 i KPRK-ës, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë së Themelore në Gjilan, me numër PP.II.nr.1913/2018, të datës 27.12.2018, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 20.03.2019 dhe pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurit, mori dhe publikisht shpalli këtë:

**A K T G J Y K I M**

I pandehuri Q. L., nga babai ..... dhe nëna ....., e lindur ....., i lindur me datë 23.07.2000, në Gjilan, ku edhe jeton në lagjen “.....” (tek vishnjet), nxënës në shkollën e smesme “.....”, në Gjilan, i pa martuar, i papunë, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

**ËSHTË FAJTOR**

Sepse me datë 01.11.2018, mes orës 15:00-16:40 minuta, në oborrin e SH.M Teknike “Mehmet Isai” në Gjilan, pas një mosmarrëveshje dhe konfrontimi fizik mes dy grupe nxënësish në oborrin e kësaj shkolle, i pandehuri Q. L. sulmon njërin nga personat e involvuar në këtë përleshje-rrahje fizike tani të dëmtuarin E. H., të cilin paraprakisht e sulmon dhe e godet me boks në shpindë, dhe largohet nga vendi i ngjarjes me qëllim që mos të hetohet.  
-Me çka kryer veprën penale, sulmi nga neni 187 paragrafi 1 i KPRK-ës.

Andaj, në bazë të nenit 4,41,42,49,50,51,52,73,74,75 dhe 76 të KPRK-ës dhe neneve 248 e 365 të KPP-ës, të pandehurit të lartcekur i shqiptohet:

## DËNIMI ME KUSHT

Ashtu që të pandehurit Q. L., i shqiptohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në periudhën kohore prej 1 (një) viti nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale, në të kundërtën gjykata dënimin me kusht do ta revokojë.

I dëmtuari E. H., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëohet në kontest të rregullt juridiko civil.

Obligohet i pandehuri që të paguajë shpenzimet procedurale sipas përlllogaritjes përfundimtare të gjykatës si dhe paushallin gjyqësor në shumë prej 20 € (pesëdhjetë euro), gjitha këto në afat prej 15 ditësh pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

## A R S Y E T I M

### 1.Rrjedha e çështjes

Prokuroria Themelore në Gjiilan, Departamenti i Përgjithshëm, me datë 28.12.2018, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr. 1913/2018, ndaj të pandehurit Qlirim Lakna, për shkak të veprës penale sulmi nga neni 187 paragrafi 1 të KPRK-ës.

Me datë 20.03.2019, pranë kësaj gjykate është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar në të cilën ishin prezent prokurori i shtetit Esat Ademi, i pandehuri Q. L.. Në këtë seancë pasi prokurori i shtetit lexoi aktakuzën, i pandehuri ka deklaruar se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet dhe se e pranon fajësinë për kryerjen e veprës penale e cila i vihet në barrë mirëpo duke shtuar se është e vërtetë se ai e ka kryer veprën penale të sulmit mirëpo nuk e ka goditur të dëmtuarin V. K. ngase i njejtë është shok i të pandehurit dhe se ai ka qenë në anën e tij por ai e ka goditur të dëmtuarin E. H. me çrast prokurori i shtetit ka deklaruar se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit dhe meqenë përshkrimi faktik i veprimeve inkriminuese të të pandehurit është i njejtë ashtu siq është përshkruar në dispozitivin e kësaj aktakuze me përjashtim të faktit se i dëmtuari i cilësuar sipas aktakuzës V. K., pas marrjes së informatave nga tani i pandehurit Q. L., i cili pranon faktin gjatë kësaj përlëshje fizike e ka sulmuar dhe ka goditur njërin nga pjesëmarrësit por jo V. K. por E. H., i njejtë ka bërë përmirësimin e këtij gabimi teknik dhe në vend të të dëmtuarit V. K. ka deklaruar se duhet të jetë E. H., andaj gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të palëve dhe por në pajtim me nenin 248 paragrafi 1 të KPP-ës ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë nga ana e të pandehurit.

### 2.Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Gjykata pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në të cilin kanë qenë palët e lartcekura, pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të pandehurit për veprën penale për të cilën akuzohet ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë si në kuptim të nenit 248 paragrafi 1 të KPP-së dhe se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit nuk është kundërshtuar nga ana e palëve prezente. Në këtë aspekt gjykata ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga ana e të pandehurit, se i pandehuri nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, se pranimi i fajësisë

mbështetet në faktet e çështjes të cilat i përmbanë aktakuza dhe se aktakuza nuk përmbanë asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

### 3.Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: se e pandehuri Q. L., ka kryer veprën penale: sulmi nga neni 187 paragrafi 1 i KPRK-ës, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### 4.Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e shqiptimit të dënimit ka vlerësuar se të pandehurit duhet ti shqiptohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në periudhën kohore prej 1 (një) viti nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale, ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe përgjegjësinë penale të kryesit dhe si i tillë me këtë dënim mund të arrihen qëllimet e dënimit në kuptim të nenit 41 të KPRK-ës, gjithashtu gjykata me rastin e matjes së dënimit ka marrë për bazë edhe rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit duke u bazuar në nenet 73,74,75 dhe 76 të KPRK-së, ashtu që rrethanë posaçërisht lehtësuese ka marrë faktin se i pandehuri ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë në një fazë të hershme të procedurës penale, se i njëjti është penduar dhe ka shfaqur keqardhje për veprimet e tij dhe ka kërkuar falje përveprimet e tij, gjykata mori parasysh edhe faktin se i pandehuri është i ri në moshë gjegjësisht është nxënës në shkollën e mesme, po ashtu edhe faktin se i njëjti ka premtuar që në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla dhe as vepra të tjera penale dhe se me të dëmtuarin i kanë rregulluar raportet dhe se prej ditës kur ka ndodhur rrahja më nuk kanë pasur probleme, gjykata ka marrë parasysh edhe rrethanat personale dhe karakterin e të pandehurit ku nga shkresat e lëndës shihet se për të pandehurin është hera e parë që i njëjti bie ndesh ligjin, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata mori parasysh faktin se me veprimin e të pandehurit, të dëmtuarit E. H. i është sulmuar integriteti trupor andaj gjykata konsideron dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit të lartcekur duke i marrë parasysh rrethanat e përmendura më lartë është dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit po ashtu gjykata konsideron se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit nga neni 41 të KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehja e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

### 5.Vendimi për kërkesën pasurore juridike.

Sa i përket kërkesës pasurore juridike, gjykata në bazë të nenit 463 paragrafi 1 dhe 2 të KPP-ës për realizimin e kërkesës pasurore juridike, të dëmtuarin E. H. e udhëzoi në kontest civil.

### 6.Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të të pandehurit, gjyqtari i vetëm gjykues duke u bazuar në nenin 451 paragrafi 1 të KPP-së, ka vendosur që të pandehurin ta detyrojë t'i paguajë shpenzimet procedurale sipas përlllogaritjes përfundimtare nga ana e gjykatës si dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 20 € (njëzetepesë euro), të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë.

Andaj duke u bazuar në të lartcekura gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN  
Departamenti i Përgjithshëm  
P.nr.28/2019, me datë 20.03.2019

Procesmbajtësja,  
Berna Maliqi

Gjyqtari i vetëm gjykues,  
Rilind Sermaxhaj

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj Gjykate Themelore.